



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry Environment Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/ Kancelarija Generalnog Sekretara/ Office of the  
General Secretary

Nr. \_\_\_\_\_/2024

Data: 20/09/2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës dhe Agjencive të Pavarura ( Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.7 datë 01 mars 2019, Prishtinë ), shtojca 1 pika 10 Rregullores (QRK) – Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive , në bazë të nenit 5 paragrafi 5.1, neni 15,21 dhe neni 23 paragrafi 1,2,3 të Ligjit nr. 2003/11 për Rrugët i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-120, Ligjit Nr.05/L-88 Për Rregullat e Trafikut Rrugor nga neni 4 paragrafi 1 nenparagrafi 2.3, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**1. Mbyllet rruga Rajonale R-115 Segmenti: Prizeren – Prevall, me rastin e asfaltimit, për projektin ‘Rikonstruimi i rrugës Rajonale R-115 segmenti:Prizeren - Prevall, Loti 1 MIT 19061511 Nr.iden:205-19-5392-5-1-1.**

1.1. Segmenti i mbylljes është lokacioni nga dalja e Prizerenti ( Marashi ) deri te tuneli i parë rruga për Llokovicë.

1.2. Mbyllja e rrugës fillon nga data 23/24/ dhe 25 shtator 2024 ndërsa intervali kohor është ora 09:00 deri në oren 17:00h.

1.3. Trafiku do të zhvillohet sipas planit të sinjalizimit të përcaktuar me këtë vendim, rruga në të cilën zhvillohet trafiku duhet të mirëmbahet dhe të mbrohet, në mënyrë që t’i përgjigjet qëllimit të vet dhe kërkesave të sigurisë së trafikut, në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi Rrugët dhe me dispozitat të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor në fuqi.

1.4. Me rastin e ndërtimit, rekonstruktimit të rrugës,të konsultohet me komunitetin të cilit i shërben rruga për t’i përcaktuar kushtet dhe mënyrat e vendosjes së shenjave dhe të drejtuarit e trafikut rrugor.

1.5. Në aksin e rrugës ku kryhen punime, duhet të shënohet në mënyrë të dukshme përmes materialeve retro-reflektuese, me qëllim që të sigurohen pjesëmarrësit në trafik. Nëse largimi i pengesave nga rruga është i pamundshëm, ato duhet të shënohen në mënyrë të tillë që të jenë të dukshme ditën dhe natën, shenjat përkatëse duhet të jenë të ngjyrosura sipas standardeve të parapara. Në rast të dukshmërisë së dobësuar duhet të vendoset edhe drita vezulluese ngjyrë portokalli.

1.6. Para fillimit të punimeve, personi i autorizuar duhet të marrë leje nga organet kompetente dhe ta informojë policinë.

1.7. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi e bënë menaxheri i kontratës z.Bahti Nabiu pandërprerë deri në përfundimin e punimeve, Policia e Kosovës dhe Departamenti i Inspektionit në MMPHI.

4. Divizioni i Informimit në MMPHI do të informon pjesëmarrësit në trafik lidhur me këtë vendim.

**VI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.**

**Izedin Bytyqi**  
**Sekretar i Përgjithshëm zv**



**Vendimi i dërgohet:**

- *Kabinetit të Ministrit;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Policisë së Kosovës-Departamentit të Trafikut*
- *Komunës të Prizerenit;*
- *Departamentit i Menaxhimit të Rrugëve;*
- *Departamentit të Inspektoratit të MI-së;*
- *Arkivit të MMPHI-së.*